

**20160050216**

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR NËPUNËS ADMINISTRATIVË**

Neni 1

Në Ligjin për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14, 199/14, 48/15 dhe 154/15), në nenin 16 paragrafi (1) alineja 7 fjalët: "apo Aptis," shlyhen.

Neni 2

Në nenin 23 pas paragrafit (9) shtohet paragraf i ri (10) si vijon:

"(10) Me përjashtim nga paragrafi (9) i këtij neni në rast të zgjedhjes së Qeverisë kalimtare në pajtim me nenin 43 të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/13, 139/14 dhe 196/15), mandati i sekretarit vazhdon deri në skadimin e mandatit të Qeverisë kalimtare."

Neni 3

Në nenin 24 paragrafi (2) pika g) alinetë 1 dhe 2, në nenin 25 paragrafi (2) pika g) dhe në nenin 26 paragrafi (2) pika g) fjalët: "apo Aptis," shlyhen.

Neni 4

Në nenin 39 në paragrafin (9) fjalët: "APTIS (APTIS)" shlyhen.

Neni 5

Në nenin 73 në pikën 26 lidhëza "dhe" zëvendësohet me pikëpresje.

Në pikën 27 pika zëvendësohet me pikëpresje.

Pas pikës 27 shtohen 3 pika të reja 28, 29 dhe 30 si vijojnë:

"28) në procedurë administrative nuk kërkon prova dhe të dhëna me detyrë zyrtare në afatin e përcaktuar me ligj;

29) në procedurë administrative nuk dërgon prova dhe të dhëna që kërkohen me detyrë zyrtare në afatin e përcaktuar me ligj dhe

30) nuk i zgjdh lëndët në procedurë administrative në afatin e përcaktuar me ligj."

Neni 6

Pas nenit 104 shtohet paragraf i ri 104-a, si vijon:

Neni 104-a

Sekretarëve shtetërorë të emëruar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji u vazhdon mandati deri në skadimin e mandatit të Qeverisë kalimtare të zgjedhur në pajtim me nenin 43 të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/13, 139/14 dhe 196/15).

Neni 7

Pas mbarimit të vlerësimit të nëpunësve administrativë në vitin 2015 nuk do të miratohet aktvendim për realizimin e masave për efekt të shkëlqyeshëm dhe të dobët në pajtim me nenin 68 paragrafi (6) të Ligjit për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14, 199/14, 48/15 dhe 154/15).

Neni 8

Dispozitat nga neni 5 i këtij ligji me të cilin ndryshohet dhe plotësohet neni 73 i Ligjit për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14, 199/14, 48/15 dhe 154/15) do të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".